



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE (QRK) - NR. 18/2024 PËR PËRCAKTIMIN E
PROCEDURAVE EFEKTIVE PËR IDENTIFIKIMIN, RAPORTIMIN
DHE REFERIMIN NDAJ SHFRYTËZIMIT, NEGLIZHIMIT DHE
ABUZIMIT TË FËMIJËS SI DHE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS NË
SITUATË RRUGE¹**

¹ Rregullore (QRK) – Nr.18/2024 për Përcaktimin e Procedurave Efektive për Identifikimin, Raportimin dhe Referimin ndaj Shfrytëzimit, Neglizhimit dhe Abuzimit të Fëmijës si dhe për Mbrojtjen e Fëmijës në Situatë Rruge, është miratuar në mbledhjen e 208 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 02/208, të dates 13.06.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 26 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe nenin 8, paragrafin 4 (nën paragrafin 4.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19, paragrafin 6 (nënpargraf 6.2) të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë, (Gazeta Zyrtare Nr. 15, datë 12 shtator 2011),

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) Nr. 18/2024 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE EFEKTIVE PËR IDENTIFIKIMIN, RAPORTIMIN DHE REFERIMIN NDAJ SHFRYTËZIMIT, NEGLIZHIMIT DHE ABUZIMIT TË FËMIJËS SI DHE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS NË SITUATË RRUGE

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurave efektive për identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës si dhe për mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga të gjitha institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal, personat fizik dhe juridik, duke përfshirë profesionistët dhe personat të cilët punojnë me fëmijën, që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e tyre.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me shprehjet në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës.

2. Në tërë tekstin e kësaj Rregulloreje kur theksohet procedura efektive për identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, nënkupton edhe mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge, përveq nëse është specifikuar ndryshe në nenin përkatës.

Neni 4 Parimet Udhëheqëse

1. Në të gjitha veprimet dhe vendimet që ndërmerren për mbrojtjen e fëmijës, institucionet, komuniteti dhe familja duhet të udhëhiqen nga parimet e proklamuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligji përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës.

2. Institucionet, profesionistët dhe personat përgjatë gjithë punës, funksionimit dhe zbatimit të mandatit të tyre duhet të kenë parasysh dhe të zbatojnë me prioritet parimet e përcaktuara në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës për të siguruar që jeta, dinjiteti, integriteti dhe interesi më i mirë i fëmijës është i garantuar dhe mbrojtur në çdo moment.

KAPITULLI II PROCEDURA EFEKTIVE E MBROJTJES SË FËMIJËS

Neni 5 Parandalimi i shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës

1. Për të realizuar të drejtat e fëmijës për mbrojtje nga shfrytëzimi, neglizhimi dhe abuzimi, sistemi i mbrojtjes së fëmijës duhet të:

1.1. veprojnë në drejtim të parandalimit të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës;

1.2. mundësojnë veprim të shpejtë dhe të koordinuar për të ndaluar abuzimin dhe mbrojtur fëmijën nga abuzimi dhe neglizhimi i mëtutjeshëm;

1.3. sigurojnë ndërhyrjen e duhur për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sigurt të fëmijës.

2. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës duhet të jenë proaktive dhe reaguese, me qëllim të parandalimit dhe reagimit në rast të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës si dhe mbrojtjes së fëmijës në situatë rruge.

3. Në kuadër të përgjegjësisë dhe obligimeve të tyre, institucionet përkatëse ndërmarrin iniciativë që ndërgjegjësojnë mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës në vazhdimësi.

4. Të gjitha institucionet që punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me fëmijët hartojnë politikën e brendshme për Mbrojtjen e Fëmijës që përfshinë:

4.1. parandalimin e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, si dhe mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge;

4.2. ngritjen e kapaciteteve të punonjësve për trajtimin e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit si dhe mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge;

4.3. krijimin e mekanizmave për identifikimin, referimin dhe raportimin e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit si dhe mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge;

4.4. reagimin institucional dhe rritjen e masave mbrojtëse që promovojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës.

5. Institucionet publike, jo qeveritare dhe private si dhe personat përgjegjës në kuadër të mandatit dhe kompetencave, që punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me fëmijë marrin pjesë në procesin e mbrojtjes së fëmijës nga shfrytëzimi, neglizhimi dhe abuzimi, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

6. Menaxhimin e procesit, koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës e bën Qendra për Punë Sociale.

Neni 6

Identifikimi i shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës

1. Identifikimi i shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës bëhet nga prindi apo kujdestari, fëmija, si dhe çdo person juridik dhe fizik.

2. Identifikimi mund të vijë si rezultat i dyshimit apo shqetësimit lidhur me cënueshmërinë e mirëqenies së fëmijës.

3. Në identifikimin e shfrytëzimit, neglizhimit apo abuzimit me fëmijë, duhet të merret parasysh edhe njohja e shenjave, simptomeve dhe faktorëve të rrezikut tek fëmija ose sjelljet e fëmijës dhe familjes që tregojnë mundësinë e abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit të fëmijës.

4. Vërtetimi i dyshimit të bazuar mund të bëhet drejtpërdrejt apo indirekt nga vetë fëmija apo nga persona të tjerë që kanë njohuri ose dyshim të bazuar se fëmija është abuzuar.

Neni 7

Konsultimi dhe trajtimi fillestar brenda institucionit ku bëhet identifikimi

1. Çdo person, pas dyshimit të arsyeshëm, duhet të konsultohet me stafin përgjegjës brenda institucionit, me kusht që procesi i konsultimit nuk e ngadalëson ose vonon kujdesin apo masat urgjente të mbrojtjes së fëmijës.

2. Nëse është e nevojshme, konsultimet bëhen edhe me shërbime të tjera për të cilat supozohet se kanë njohuri për fëmijën dhe familjen, me qëllim të mbledhjes së të dhënave shtesë për fëmijën dhe familjen, vlerësimin e rrezikut ndaj fëmijës dhe pajtimin për hapat e mëtutjeshëm që duhen ndërmarrë.

3. Nëse nuk ka kushte për konsultime të tilla në nivelin e institucionit, ose vlerësohet se procesi i konsultimit mund të rrezikojë interesin e fëmijës, rasti duhet të referohet dhe raportohet pa vonesë në Qendrën për Punë Sociale më të afërt ose në Polici.

4. Politika për mbrojtjen e fëmijës e hartuar nga institucioni përcakton në mënyrë të detajuar se cilat raste mund të trajtohen brenda institucionit, mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve, diagramin e reagimit dhe raportimit si dhe përcaktimin e pikës së kontaktit brenda institucionit përkatës që është përgjegjës për referimin e rastit.

Neni 8

Dokumentimi i gjendjes së fëmijës dhe rrethanave të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit

1. Institucionet dhe profesionistët sipas obligimeve të tyre ligjore bëjnë identifikimin dhe dokumentimin e gjendjes së fëmijës të shfrytëzuar, neglizhuar dhe abuzuar.

2. Dokumentacioni i mbledhur përdoret si provë e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës për procedurat e mëtejshme të mbrojtjes së fëmijës.

Neni 9

Raportimi dhe referimi i dyshimeve

1. Çdo person që vëren ose ka informacion për një situatë të dyshuar ose rast të dhunës fizike ose mendore, keqtrajtimit, braktisje, shfrytëzimi, abuzimi, neglizhimi të fëmijës është i obliguar që të raportojë rastin në Polici ose në Qendrën përkatëse për Punës Sociale.

2. Prindi ose kujdestari si dhe çdo person tjetër, nëse ka arsye për të dyshuar se ndaj fëmijës është ushtruar çdo formë e shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit është i obliguar që të raportojë rastin me shkrim ose gojarisht në Polici si dhe në Qendrën përkatëse për Punës Sociale.

3. Profesionisti për mbrojtjen e fëmijës, përfshinë, por nuk kufizohet në: edukator, mësues, mjek, stomatolog, infermier, psikolog, punonjës social, policë, çdo ofrues i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës publik, privat ose përfaqësues i organizatave joqeveritare për mbrojtjen e fëmijës, dhe kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar dhunë është abuzuar, keqtrajtuar, braktisur, shfrytëzuar apo neglizhuar është i obliguar që rastin ta raportojë me shkrim ose gojarisht në Polici, në Qendrën përkatëse për Punë Sociale si dhe në Zyrën përkatëse për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.

4. Pas raportimit të rastit Qendra përkatëse për Punë Sociale njofton Policinë në çdo rast të referimit të mbrojtjes së fëmijës dhe anasjelltas, Policia njofton Qendrën përkatëse për Punë Sociale në çdo rast të raportimit të rasteve si të identifikuar, të dyshuar ose të abuzuar.

5. Të gjithë profesionistët apo institucionet që referojnë dhe raportojnë rastet duhet t'i përgjigjen thirrjes së organeve përgjegjëse për trajtimin e rasteve, të bashkëveprojnë në trajtimin e situatës së fëmijës dhe në zbatimin e planit të mbrojtjes, gjegjësisht ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

6. Raportimi për rastin e fëmijës që ka nevojë për mbrojtje mund të bëhet me çdo mjet komunikimi si përmes telefonit, e-mailit, postës, shkresave, komunikimin me zyrtarët policor dhe strukturat përkatëse të mbrojtjes së fëmijës, duke ruajtur konfidencialitetin në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 10

Procedurat në menaxhimin e rastit

1. Pas raportimit dhe referimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, Qendra përkatëse për Punë Sociale me qëllim të menaxhimit të rastit duhet të ndjekë, por jo vetëm hapat e si në vijim:

1.1. vlerësimi i rastit fillestar dhe gjithëpërfshirës;

1.2. plani i individualizuar i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës;

1.3. zbatimi i planit të shërbimeve dhe monitorimi i rastit;

1.4. mbyllja e rastit.

2. Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve sipas nevojës, të cilat i përgjigjen interesit më të mirë të fëmijës.

Neni 11

Vlerësimi fillestar dhe gjithëpërfshirës i rastit

1. Pas referimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, Qendra për Punë Sociale është e obliguar të ndër marr të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme për verifikimin e informacionit dhe vlerësimin e rastit.

2. Vlerësimi i rastit përfshinë vlerësimin fillestar dhe vlerësimin gjithëpërfshirës.

3. Vlerësimi fillestar është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut bazuar në informacionin e disponueshëm. Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me institucionet përkatëse është përgjegjëse për vlerësimin fillestar.

4. Vlerësimi fillestar duhet të bëhet dhe përfshinë:

- 4.1. sigurinë e fëmijës dhe nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër;
 - 4.2. ofrimin e shërbimeve të domosdoshme dhe urgjente.
5. Pas vlerësimit fillestar, Qendra për Punë Sociale në koordinim me institucionet përkatëse, harton raportin profesional të vlerësimit.
6. Vlerësimi gjithëpërfshirës identifikon:
- 6.1. nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë;
 - 6.2. nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin;
 - 6.3. kapacitetin dhe potencialin e fëmijës, familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë;
 - 6.4. vlerësimi gjithëpërfshirës duhet përfunduar në përputhje me afatet e parapara në standardet minimale të cilësisë.
7. Procesi i vlerësimit gjithëpërfshirës në:
- 7.1. vëzhgim dhe bisedë me fëmijën në përputhje me moshën dhe aftësitë e komunikimit të fëmijës, me prindërit, anëtarët e familjes dhe personat e tjerë që ndërlidhen me gjendjen e fëmijës dhe familjes;
 - 7.2. mbledhje dhe analizim i të dhënave përkatëse nga ekspertë të shërbimeve të tjera me të cilët fëmija dhe familja kanë përfituar shërbime nga institucionet relevante;
 - 7.3. vlerësim të dëmtimeve që i janë shkaktuar fëmijës, përkatësisht vlerësim të rrezikut ndaj të cilit ekspozohet fëmija;
 - 7.4. identifikim i masave dhe shërbimeve që mund të përdoren për të mbrojtur fëmijën në familje;
 - 7.5. vendim lidhur me masat dhe shërbimet e mëtejshme në Qendër për Punë Sociale ose nga shërbimet e tjera.

Neni 12

Plani i individualizuar i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës

1. Plani i individualizuar i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës hartohet nga menaxheri i rastit në bashkëpunim dhe koordinim me ekipin e organit të kujdestarisë në Qendra për Punë Sociale.
2. Plani i individualizuar i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës përmban:
 - 2.1. përcaktimin e objektivave dhe veprimeve në punën me fëmijën dhe familjen me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe realizimit të të drejtave të fëmijës;

2.2. caktimin e afateve kohore;

2.3. profesionistët përgjegjës për zbatimin e veprimeve të planit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

3. Në rastet kur vlerësohet se ekziston rreziku për mirëqenien dhe sigurinë e fëmijës, menaxheri i rastit cakton takim me Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit për zhvillimin e një plani të përbashkët për vlerësimin dhe bashkërendimin e veprimeve për ofrimin e shërbimeve të mëtutjshme.

4. Nëse merret vendimi për vendosjen e fëmijës në strehim alternativ, fëmija duhet të strehohet sa më shpejtë që është e mundur, si masë e ndërhyrjes së menjëhershme.

5. Qendra për Punë Sociale menjëherë duhet të fillojë procedurën e gjetjes së një zgjidhje të përhershme, afatgjate të fëmijës në familje biologjike apo jashtë saj.

Neni 13

Zbatimi i planit të shërbimeve dhe monitorimi i rastit

1. Zbatimi i planit për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi, neglizhimi dhe abuzimi përfshin poashtu procesin e monitorimit dhe vlerësimin të përshtatshmërisë së masave të planifikuara dhe të ndërmarra, si dhe afatet për rishikim.

2. Kjo procedurë gjithashtu duhet të zhvillohet në bashkëveprim me të gjitha shërbimet të përfshira në komunitet, rastet trajtohen dhe vendimet duhet të merren në takime të përbashkëta në Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit.

3. Qëllimi i procesit të monitorimit dhe rivlerësimit duhet të sigurojë interesin më të mirë të fëmijës, me qëllim të përshtatjes së shërbimeve dhe masave të mëtutjeshme në rrethanat e ndryshuara dhe nevojat e reja të fëmijës dhe familjes.

4. Në varësi të rezultateve të rivlerësimit, merret vendim në pajtim me rrethanat e ndryshuara.

Neni 14

Mbyllja e rastit

1. Rasti mbyllet kur:

1.1. pas raportimit vlerësohet që nuk ka prova dhe bazë të mjaftueshme për tu konsideruar si rast i shfrytëzimit, neglizhimit apo abuzimit;

1.2. masat, veprimet dhe shërbimet e tjera të ofruara sipas planit kanë përfunduar dhe fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera për fëmijën;

1.3. fëmija e ndërron vendbanimin nga një komunë në tjetrën dhe procesi i menaxhimit të rastit bartet në Qendrën për Punë Sociale tjetër;

1.4. fëmija e ndërron vendbanimin duke u vendosur jashtë shtetit, transferohet në shtetin e origjinës (lindjes) apo në një vend të tretë bazuar në interesin më të mirë të fëmijës;

1.5. fëmija arrinë moshën madhore;

1.6. në rast të vdekjes të fëmijës;

2. Nëse rezultatet e vlerësimit tregojnë se mjedisi jetësor i fëmijës është i sigurt dhe se prindi/kujdestari është në gjendje të sigurojë kushte për zhvillim të mëtejshëm të sigurt dhe të pandërprerë psikofizik të fëmijës, mund të merret vendim për mbylljen e rastit.

3. Përjashtimisht nga paragrafi 1, pika 1.5 e këtij neni, Qendra për Punë Sociale mund të vazhdojë shërbimet në rrethana të veçanta sipas vlerësimit profesional të Qendrës për Punë Sociale.

4. Për rastet me rrezik, vendimi për mbylljen e rastit merret në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit.

KAPITULLI III

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE PËR MBROJTJE TË FËMIJËS

Neni 15

Detyrimet e institucioneve për mbrojtje të fëmijës

1. Të gjitha institucionet dhe strukturat nga fusha që mbulojnë kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

2. Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës kanë detyrat si në vijim:

2.1. përcaktimin e masave dhe aktiviteteve sistematike që kontribuojnë në parandalimin e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës;

2.2. bashkëpunimin ndërinstitucional për shkëmbimin e informatave dhe koordinimin e punës së përbashkët;

2.3. bashkëpunimin e ngushtë me institucionet qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që zhvillojnë programe për parandalim, si dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të përbashkëta për ngritjen e vetëdijes së popullatës për efektet e dëmshme të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës.

Neni 16

Roli dhe përgjegjësitë e Qendrave për Punë Sociale

1.Roli dhe përgjegjësia e Qendrave për Punë Sociale në identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1.Identifikimin e fëmijës në rrezik nëpërmjet informacioneve të siguruar nga vetë Qendra përkatëse për Punë Sociale, marrjes së referimeve nga institucionet e tjera, organizata, anëtarët e komunitetit, publiku, familja, vetë fëmija dhe media;

1.2. menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijës në bashkëpunim me policinë dhe akterët tjerë të nevojshëm, edhe jashtë orarit zyrtar të punës;

1.3.ndërmarrjen e vlerësimit fillestar për të gjithë rastet e fëmijës së referuar;

1.4.organizimin e vlerësimeve gjithëpërfshirëse për fëmijën e referuar;

1.5.koordinimin dhe lehtësimin e takimeve të Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit për të diskutuar për çdo fëmijë të konsideruar në rrezik;

1.6.zhvillimin dhe shqyrtimin e planeve individuale të fëmijës në rrezik dhe monitorimin e zbatimit derisa rasti të mbyllet;

1.7. kur organi i kujdestarisë, Qendra për Punë Sociale ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, mund të hyjë në cilindo vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon shtatëdhjetë e dy (72) orë;

1.8. para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës;

1.9. denoncimin në polici të rasteve të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të ndodhur apo supozuar në mënyrë që të mbrohen fëmijët;

1.10. organizimin e punës së drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjet, përfshirë këshillimin dhe mbështetjen;

1.11. mbajtjen e të dhënave të sakta dhe faktike për të gjithë rastet e menaxhuara dhe referuara të fëmijës pranë qendrës përkatëse për punë sociale.

Neni 17

Roli dhe përgjegjësitë e Policisë

1.Roli dhe përgjegjësia e Policisë në identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, përfshinë por nuk kufizohet në:

1.1.identifikimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referim të menjëhershëm tek Qendra përkatëse për Punë Sociale;

1.2. largimi i menjëhershëm i fëmijës në rrezik dhe referimin pranë Qendrës përkatëse për Punë Sociale edhe kur këto raste identifikohen jashtë orarit zyrtar të punës;

1.3. lëshon urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes kur fëmijët janë në rrezik në bashkëpunim me Qendrën përkatëse për Punë Sociale;

1.4. fillimin e hetimeve në rastet kur ka dyshim të bazuar dhe prova të mjaftueshme për vepër penale të kryer ndaj fëmijës, si dhe përpilimin e kallëzimit penal ndaj të dyshuarve;

1.5. marrjen pjesë në Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën;

1.6. mbështetjen e menjëhershme të Qendrës përkatëse për Punë Sociale kur është e nevojshme, gjatë vizitave në familje, gjatë identifikimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijës që është në rrezik.

Neni 18

Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve edukativo-arsimore

1. Roli dhe përgjegjësia e institucioneve edukativo-arsimore në identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1. identifikimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë pranë policisë, Qendrës përkatëse për Punë Sociale;

1.2. lehtësimin dhe mbështetjen për ndjekjen e shkollës nga fëmijët të cilët janë identifikuar si të cenueshëm ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit;

1.3. sipas vlerësimit marrin pjesë në Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën;

1.4. edukimin e fëmijës për të parandaluar dhe shmangur situatat e rrezikshme.

Neni 19

Roli dhe përgjegjësitë e Drejtorisë përkatëse komunale për shëndetësi

1. Roli dhe përgjegjësia e Drejtorisë përkatëse komunale për shëndetësi në identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1. identifikimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje gjatë ofrimit të shërbimit shëndetësor, paraqitjes pranë qendrave përkatëse shëndetësore, referimin me kohë në polici dhe në Qendrën përkatëse për Punë Sociale;

1.2. trajtimin e rasteve të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës sipas protokollit të trajtimit dhe referimin e menjëhershëm të rastit pranë Policisë dhe Qendrës përkatëse për Punë Sociale;

1.3. përpilimin e raporteve mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës së shfrytëzuar, neglizhuar dhe abuzuar apo të supozuar si në rrezik të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit;

1.4. lehtësimin në ofrimin e shërbimeve dhe ndihmës mjekësore për fëmijën;

1.5. pjesëmarrje në Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën;

1.6. mbështetjen dhe bashkëpunimin me Qendrën përkatëse për Punë Sociale për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme informuese dhe vetëdijësuese me qëllim parandalimin e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit ndaj fëmijës.

Neni 20

Roli dhe përgjegjësitë e ofruesve të tjerë publik, joqeveritar dhe privat të shërbimeve për fëmijë

1. Roli dhe përgjegjësia e ofruesve të tjerë publik, joqeveritar dhe privat të shërbimeve për fëmijë në identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1. identifikimin dhe referimin pranë Qendrës përkatëse për Punë Sociale kur një fëmijë dyshohet apo që është shfrytëzuar, neglizhuar dhe abuzuar;

1.2. pjesëmarrjen në Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të perkujdesit të hartuara për fëmijën;

1.3. ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet në përputhje me planin e miratuar individual të mbrojtjes së fëmijës;

1.4. të bashkëpunoj me Qendrën përkatëse për Punë Sociale lidhur me zbatimin e planit;

1.5. lehtësimin e kontakteve ndërmjet fëmijës dhe familjes;

1.6. mbështetjen dhe bashkëpunimin me Qendrën përkatëse për Punë Sociale për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme informuese dhe vetëdijësuese me qëllim parandalimin e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit ndaj fëmijës.

Neni 21

Roli dhe përgjegjësitë e Departamentit për të mitur në prokurori dhe gjykatë

1. Roli dhe përgjegjësia e Departamentit për të mitur në prokurori dhe gjykatë, në identifikimin, raportimin dhe referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijës, përfshin, por nuk kufizohet në:

1.1. bashkëpunimin me Qendrën përkatëse për Punë Sociale gjatë shqiptimit të masave për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, duke përfshirë edhe vendosjen e fëmijës në strehimore ose në institucion edukativ apo të ngjashëm, vendosjen e fëmijës nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose transferimin e fëmijës në familje tjetër, nëse është e nevojshme që fëmija të ndahet nga mjedisi në të cilin ai ka jetuar ose për t'i ofruar ndihmë, mbrojtje apo strehim;

1.2. pjesëmarrjen në Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, sipas nevojës dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të përkujdesit të hartuara për fëmijën;

1.3. mbështetjen dhe bashkëpunimin me institucionet tjera për zhvillimin e aktiviteteve informuese dhe vetëdijësuese me qëllim të parandalimit të shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit ndaj fëmijës.

KAPITULLI IV BASHKËPUNIMI, RAPORTIMI DHE ZBATIMI

Neni 22 Bashkëpunimi dhe koordinimi

1. Ministria përkatëse për Drejtësi ka rol koordinues në procesin e mbrojtjes së fëmijës.

2. Për të krijuar një rrjet efikas, operacional, ndër-ministror për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi, neglizhimi dhe abuzimi, obligohen të bashkëpunojnë të gjitha ministratë përkatëse sipas fushave që mbulojnë në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

3. Për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijës nga shfrytëzimi, neglizhimi dhe abuzimi, obligohen që institucionet, organizatat e tjera dhe të tjerët që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës t'i përmbahen parimeve themelore dhe qëllimeve të kësaj Rregulloreje.

Neni 23 Mirëmbajtja e të dhënave

1. Qendra përkatëse për Punë Sociale mbanë të dhëna në vijim:

1.1. të dhëna individuale rreth menaxhimit të rastit të fëmijës;

1.2.evidenton dhe përditëson bazën e të dhënave të rasteve të fëmijëve të shfrytëzuar, abuzuar, neglizhuar dhe fëmijës në situatë ruge.

1.3.evidentimi në bazën e të dhënave është përgjegjësi e menaxherit të rastit në kuadër të Qendrës përkatëse për Punë Sociale dhe qasje në ato të dhëna mund të kenë vetëm personat e autorizuar.

2.Ministria përkatëse për Drejtësi krijon, mirëmbanë dhe menaxhon bazën e të dhënave.

Neni 24

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale

Të gjitha të dhënat trajtohen në pajtim me parimet për ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë në pajtim me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës.

Neni 25

Përgjegjësia për zbatim

1. Të gjitha institucionet relevante të Republikës së Kosovës, në pajtim me mandatin dhe përgjegjësitë e përcaktuara, obligohen të planifikojnë dhe ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

2.Institucionet relevante publike dhe private janë të detyruar të marrin masat e nevojshme për të siguruar strukturën, organizimin, pajisjet, trajnimin dhe numrin e mjaftueshëm të ekspertëve të specializuar që merren me çështjen e shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijëve në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Datë: 18 qershor 2024